

LIGJ
Nr. 130/2012

**PËR TRAJTIMIN DHE ADMINISTRIMIN E MJETEVE RRUGORE E LUNDRUESE TË
KONFISKUARA, SI PASOJË E SEKUESTRIMIT, NDALIMIT APO BLOKIMIT NGA
POLICIA E SHTETIT DERI NË DATËN 30.12.2010**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
MJETET RRUGORE

Neni 1

Mjetet rrugore, të regjistruara e të pajisura me leje qarkullimi nga organet kompetente shqiptare, të konfiskuara si pasojë e sekuestrimit, ndalimit apo bllokimit nga organet e Policisë së Shtetit deri në datën 30.12.2010, për të cilat nuk ka probleme në ndjekje, në hetim ose verifikime të ndryshme, kalojnë dhe administrohen nga Rezervat Materiale të Shtetit, për vijimësinë e procedurave të mëtejshme, sipas administrimit të parashikuar në legjislacionin në fuqi.

Neni 2

Mjetet rrugore, të cilat nuk janë të regjistruara e të pajisura me leje qarkullimi nga organet kompetente shqiptare (me ose pa targa regjistrimi/leje qarkullimi nga një shtet i huaj) dhe plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji, pas rikonfirmimit të verifikimeve me shtetet e origjinës, kalojnë dhe administrohen nga Rezervat Materiale të Shtetit, për vijimësinë e procedurave të mëtejshme, sipas administrimit të parashikuar në legjislacionin në fuqi.

KREU II
MJETET LUNDRUESE

Neni 3

Mjetet lundruese, të regjistruara e të pajisura me leje lundrimi dhe me certifikatën e përdorimit të mjetit lundrues nga organet kompetente shqiptare, të konfiskuara si pasojë e sekuestrimit, ndalimit apo bllokimit nga organet e Policisë së Shtetit deri në datën 30.12.2010, për të cilat nuk ka probleme në ndjekje, në hetim ose verifikime të ndryshme, kalojnë dhe administrohen nga Rezervat Materiale të Shtetit, për vijimësinë e procedurave të mëtejshme, sipas administrimit të parashikuar në legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Mjetet lundruese, të cilat nuk janë të regjistruara e të pajisura me leje lundrimi dhe certifikatën e përdorimit të mjetit lundrues nga organet kompetente shqiptare (me ose pa leje lundrimi nga një shtet i huaj) dhe plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji, pas rikonfirmimit të verifikimeve me shtetet e origjinës, kalojnë dhe administrohen nga Rezervat Materiale të Shtetit, për vijimësinë e

procedurave të mëtejshme, sipas administrimit të parashikuar në legjislacionin në fuqi.

KREU III

Neni 5

Kalimi i këtyre mjeteve nga mjediset e drejtorive të policisë së qarqeve përkatëse dhe ato të Policisë Kufitare dhe Migracionit bëhet pranë mjediseve të drejtorisë rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit, që korrespondon me territorin respektiv. Procedurat e kalimit dhe të çregjistrimit rregullohen me akt nënligjor të Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punëve Publike dhe Transporte.

Neni 6

Të ardhurat e gjeneruara, sipas përcaktimeve në nenet 1, 2, 3 e 4 të këtij ligji, të përdoren sipas legjislacionit në fuqi. Ministria e Financave dhe Ministria e Brendshme ngarkohen të nxjerrin udhëzim të përbashkët në zbatim të këtij neni.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 27.12.2012

Shpallur me dekretin nr.7926, datë 11.1.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani